

15.02.2022
Ora 16:03

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për rregullat proceduriale për procesin e votimit dhe numërimit elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN) në qendrat e votimit të Bashkisë Vorë, Qarku Tiranë, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.


PJESËMARRJA :

KQZ:

- Ilirjan **CELIBASHI** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- Komisioni Rregullator:
- Ilirjana **NANO** Kryetar
- Arens **ÇELA** Anëtar
- Dritan **ÇAKA** Anëtar
- Helga **VUKAJ** Anëtar
- Muharrem **ÇAKAJ** Anëtar
- Stafi **KQZ** Y.Merkaj, A.Agolli, E.Këlliçi
- Parti Politike: S’ka

Znj. I. Nano: Mirëmbërëma! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për datën e sotme, 15 shkurt 2022. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të administratës. Në rendin e ditës së mbledhjes kemi shqyrtimin e projektvendimit “Për rregullat proceduriale për procesin e votimit dhe numërimit elektronik, nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit PEVN, në qendrat e votimit të Bashkisë Vorë, Qarku

Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.15.02.2022*

Tiranë, për zgjedhjet e pjeshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”. Sipas rregullores kolegë, nëse ka ndonjë çështje për diskutim jashtë rendit të ditës, e prezantojmë në këtë moment dhe e diskutojmë në fund, ka ndonjë çështje? Jo! Atëherë vijojmë me shqyrtimin e projektvendimit që kemi në rendin e ditës. Duke qenë që është një propozim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, do t’i lutesha Sekretarit të Përgjithshëm, zotit Merkaj, të prezantonte shkurtimisht projektvendimin.

Z. Y. Merkaj: Pika 1 e nenit 22 të Kodit Zgjedhor përcakton kompetencën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të eksplorojë, eksperimentojë dhe të vendosë përdorimin në zgjedhje të sistemeve, ose të pajisjeve të teknologjisë së informacionit për të mbuluar aspekte dhe, ose procedura të veçanta të procesit zgjedhor. Përdorimin e sistemeve dhe, ose të pajisjeve të teknologjisë së informacionit, KQZ-ja është e detyruar ta zbatojë në zgjedhje nëpërmjet projekteve pilot, jo më pak se 10% të numrit të zgjedhësve për çdo fazë të implementimit. Ndërsa në pikën 3, të nenit 21, të Kodit Zgjedhor përcaktohet se përdorimi i sistemeve, ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit bëhet në përputhje me rregullat e posaçme lidhur me procedurat e aspekteve të veçanta të procesit që mbulohen nga sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit, rregullat, procedurat për këtë qëllim miratohen me akt normativ të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Referuar pikës 4, të nenit 12 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Rregullator është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe e vendosjes së rregullave për zgjedhjet. Për këtë arsye kemi përgatitur projektvendimin e mësipërm. Ky projektvendim hartohet në kuadër të risisë që solli Kodi Zgjedhor, për prezantimin e teknologjisë së informacionit për të mbuluar procese të caktuara zgjedhore. Komisioni Rregullator ka miratuar me vendim nr.4, datë 13.11.2020 llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet apo pajisjet e

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.15.02.2022*

teknologjisë së informacionit që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në datën 1 shkurt 2022 ka miratuar vendimin e caktimit të Bashkisë Vorë, si njësinë administrative për zbatimin e projektit pilot, për procesin e votimit dhe të numërimit elektronik të votave për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022. Me qëllim implementimin e këtij projekti pilot në Bashkinë Vorë, Komisioni Rregullator miraton rregullat e posaçme lidhur me procedurat për aspekte të veçanta të procesit që mbulohen nga sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit. Qëllimi i këtij projektvendimi është përcaktimi i rregullave procedurale për mënyrën sesi do të implementohet projekti pilot për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore për Bashkinë Vorë dhe si do të vlerësohet efektshmëria dhe efikasiteti i tij për të vijuar në faza të tjera të implementimit në këto lloj zgjedhjesh. Si rregull çdo qendër votimi duhet të ketë dy pajisje elektronike të votimit dhe numërimit elektronik, përjashtimisht për zgjedhjet e Bashkisë Vorë, do të ketë nga një pajisje për çdo qendër votimi. Për çdo qendër votimi do të ketë edhe një 5-përqindësh, e cila do të konsiderohet si pajisje zëvendësuese në rast problemesh teknike, në qoftë se do të ndodhin gjatë procesit zgjedhor. Gjithashtu, për shkak të dinamikës së proceseve zgjedhore dhe ndërveprim të rregullave procedurale standarde dhe pamundësisë për të evidentuar në detaje problematikat dhe risqet që mund të shoqërojnë implementimin e këtij projekti, autorizohet Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve të udhëzojë administratën zgjedhore për të gjitha veprimtaritë operationale për dorëzimin e bazës materiale apo procedurale që autorizohen për shkak të implementimit të teknologjisë së informacionit. Në projekt është parashikuar që KQZ-ja i dorëzon KZAZ-së materialet zgjedhore të përcaktuara në nenin 18, të vendimit nr.11, datë 25.03.2021, të Komisionit Rregullator, si dhe i dorëzon dhe PEVN dhe kutinë shoqëruese që mundësojnë votimin elektronik. KZAZ-ja i dorëzon komisionit të qendrës së votimit materialet

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.15.02.2022*

zgjedhore dhe PEVN me kutitë shoqëruese që mundësojnë votimin elektronik, si dhe procesverbalet dhe dokumentacionin e punës të përshtatur për këtë bashki. Për të garantuar të drejtën e zgjedhësve me aftësi të kufizuar është parashikuar e drejta ligjore për votimin me ndihmën e një familjari, ose zgjedhësi tjetër që është në listën e zgjedhësve të kësaj qendre votimi. Në rastet kur votimi elektronik për arsye teknike që lidhen me pajisjen e votimit nuk mund të fillojë, ose kur ka filluar është ndërprerë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendos të vijojë votimi, procedura e votimit me fletë votimi sipas vlerësimit të situatës nga ana e tij. Personeli teknik i ngarkuar nga KQZ-ja për përdorimin e PEVN-së, në përfundim të votimit kryen mbylljen e procesit në pajisjen elektronike të votimit dhe numërimit dhe skanon në sistem rezultatin e zgjedhjeve për atë qendër votimi dhe e dërgon elektronikisht në aplikacionin e ngritur posaçërisht nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Rezultati paraprak nxirret dhe publikohet pasi është dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, rezultati i votimit për çdo qendër votimi të Bashkisë Vorë. Procesi i nxjerrjes së rezultatit për çdo qendër votimi dhe në rang bashkie realizohet nga KZAZ-ja në ambientet e VNV-së së përcaktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Pas mbylljes së votimit, komisioni i qendrës së votimit dorëzon në VNV pajisjet e PEVN-së së bashku me materialet e tjera zgjedhore. Pas dorëzimit nga të gjitha komisionet e qendrave të votimit pranë KZAZ-së të pajisjeve dhe materialeve përkatëse, KZAZ-ja, në prani të vëzhguesve kryen procesin e numërimit të votave në sistemin elektronik të menaxhimit dhe votimit të rezultateve. SEMVR-ja do të kryejë përlogaritjen e rezultatit dhe do të shfaqë në monitor dhe do të printojë në letër tabelën e rezultateve për çdo qendër votimi, si dhe tabelën përmbledhëse të rezultatit për Bashkinë Vorë, sipas modeleve të miratuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Në rastin kur procedura e votimit është zhvilluar në një pjesë të ditës elektronikisht dhe një pjesë tjetër manualisht, KZAZ-ja aktivizon grupet e numërimit të ndjekin procedurat

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.15.02.2022*

standarde për hapjen e kutive të votimit, numërimin, vlerësimin dhe nxjerrjen e rezultateve sipas udhëzimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vetëm pasi sistemi ka gjeneruar raportin me rezultatet e votimit për pjesën elektronike. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe materialet përkatëse, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj! Atëherë, kolegë fillojmë shqyrtimin në parim të projektvendimit. Nëse dikush dëshiron të flasë lidhur me projektvendimin në parim? Unë personalisht doja të thoja diçka lidhur me këtë vendim, nëpërmjet të cilit do të miratojmë rregullat proceduriale për procesin e votimit dhe numërimit elektronik. Për herë të parë ky proces është aplikuar në zgjedhjet e 25 Prillit 2021, rastin e KZAZ-së 40, në Qarkun e Tiranës dhe qoftë dita e votimit dhe më tej numërimi elektronik, por qoftë dhe verifikimet, apo këqyrjet paszgjedhore dëshmuuan që ky ishte një proces i suksesshëm. Sigurisht kjo është një fazë tjetër e pilotimit të përdorimit të këtyre pajisjeve dhe normalisht sikundër edhe Sekretari i Përgjithshëm në prezantimin e tij të detajuar e theksoi, në kushtet kur KQZ disponon vetëm 68 pajisje të tilla, aplikohet vetëm në një bashki. Nëse kolegët nuk kanë diçka tjetër në parim le të kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet në parim projektvendimi!

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen. Duke qenë që janë 18 të tilla, 18 pika të projektvendimit, rastet e projektvendimeve voluminoze kemi dakordësuar që të mos lexohen të gjitha. Të shqyrtohen një nga një dhe në situatën kur ka një propozim për shtesë, apo për ndryshim, propozuesi kërkon fjalën për pikën apo

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.15.02.2022*

nenin konkret. Atëherë kalojmë me pikën 1 të projektvendimit. Kemi ndonjë pyetje, sqarim apo propozim? Nëse jo, kalojmë në votimin e pikës 1.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 2 e projektvendimit. Kemi diçka kolegë, lidhur me pikën 2? Zonja Vukaj!


Znj. H. Vukaj: Një pyetje drejtuar administratës ose zotit Sekretar të Përgjithshëm. Lexoj në pikën 2, dy paragrafë, ku në paragrafin e parë shprehni rregullin, zoti Merkaj, dhe më pas në paragrafin e dytë bëni përjashtimin. Në fakt, norma në Kod është e qartë dhe meqenëse këto janë zgjedhje të pjesshme dhe dalin nga rregulli i përgjithshëm, besoj se nuk do ishte nevoja për ta vendosur rregullin, sepse tek përjashtimi ne po ndjekim logjikën, një logjikë tjetër, atë të sasisë së pajisjeve dhe në informim të publikut, unë do doja një qartësim, ose një informacion më të detajuar nga ju, se ç'ju ka shtyrë për përjashtimin dhe draftimin në këtë mënyrë në pikën 2. Faleminderit!

Z. Y. Merkaj: Atëherë në zgjedhjet e datës 25 Prill 2021 u caktua projekti pilot të bëhej në njësinë administrative nr.40, KZAZ nr.40, njësi administrative 10, në qytetin e Tiranës, e cila ka pasur 32 qendra votimi dhe duke qenë se ishim të kushtëzuar dhe nga fondet kemi prokuruar vetëm për 64 pajisje PEVN të votimit dhe numërimit elektronik. Duke qenë se Bashkia e Vorës ka 44 qendra votimi...

Z. M. Çakaj: Më fal, 68 apo 64?

Znj. I. Nano: 68 apo jo?

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Z. Y. Merkaç: 68 kemi prokuruar, por 64 kemi përdorur.

Z. M. Çakaj: Duke pasur në konsideratë dhe 5%.

Z. Y. Merkaç: Po! Dhe në Bashkinë Vorë janë 44 qendra votimi, kështu që ne nuk kemi pajisje, nuk kemi prokuruar që ta plotësojmë, që në çdo qendër votimi të ketë nga dy pajisje të PEVN-së, ashtu siç ka caktuar dhe Rregullatori për të zhvilluar procesin e votimit. Në këto kushte jemi të detyruar të bëjmë një përjashtim që në çdo qendër votimi të jetë një pajisje PEVN, duke ruajtur dhe 5-përqindëshin rezervë dhe kjo është arsyeja që kemi shënuar në projektakt. Faleminderit!

Znj. H. Vukaj: Pra, me të njëjtën sasi, duke qenë se ju nuk keni prokuruar, ju keni arritur të draftoni mbi bazën e një përlllogaritjeje sipas qendrave të votimit që janë respektivisht për Bashkinë Vorë. Në rregull, faleminderit!

Znj. I. Nano: Pra, Bashkia Vorë është bashkia me numrin më të ulët të qendrave të votimit në raport me 6 bashkitë e tjera, dhe për këtë me sa duket është përzgjedhur nga Komisioneri. Në rregull, kalojmë në votimin e pikës 2, kolegë?

Kush është dakord?


Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 3. Sikundër u theksua në trajtimin e hollësishëm të projektaktit nga Sekretari i Përgjithshëm, lidhet me procedurat e paautomatizuara, ku KZAZ-ja dhe komisioni i qendrës së votimit veprojnë në përputhje me udhëzimet

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



operacionale të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Kemi ndonjë pyetje? Po, zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Një saktësim, zonja Nano, se jam e bindur që administrata ndoshta në shpejtësinë e draftimit ka vendosur në fund të fjalisë një nga aktet duke e përgjithësuar. Pra, aty ku thuhet “vepron në përputhje me udhëzimet operacionale të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”. Udhëzimet janë një nga aktet e Komisionerit dhe unë realisht do të preferoja që në draftim të ishte, “Aktet e Komisionerit”.

Znj. I. Nano: Me aktet operacionale? Apo aktet?

Znj. H. Vukaj: Komisioneri e dimë që ka kompetencën dhe është i detyruar që të zgjidhë komplikacionet, apo problemet sa herë që ato do të paraqiten sepse është në tagrin e tij. Kështu që “aktet e Komisionerit”, mendoj që e përfshin...

Znj. I. Nano: Ta heqim “operacionale”?

Znj. H. Vukaj: Po, “udhëzimet operacionale”

Znj. I. Nano: Dhe e zëvendësojmë me “aktet e Komisionerit”


Znj. H. Vukaj: “Aktet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”. Merreni si saktësim.

Znj. I. Nano: Besoj që është saktësim. Pra, edhe për administratën gjatë zbardhjes “me aktet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.

Atëherë kalojmë në votimin e pikës 3.

Kush është dakord?

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.15.02.2022*

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 4 lidhet me dorëzimin nga KQZ-ja në KZAZ, qoftë të materialeve zgjedhore, qoftë të pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimit elektronik. Kemi ndonjë pyetje, sqarim? Jo! Kalojmë në votimin e pikës 4.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 5 lidhet me dorëzimin tashmë nga KZAZ-ja në KQV, pikërisht të materialeve dhe PEVN-ve që janë përmendur në pikën 4. Nuk kemi ndonjë diskutim. Kalojmë në votimin e pikës 5.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet pika 5!

Pika 6 lidhet me situatat kur do duhet Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve të vendosë të vijojë procedurën me fletë votimi. Zoti Çakaj, po!

Z. M. Çakaj: Faleminderit zonja Nano! Atëherë, unë kisha një propozim në pikën 6, riformulim të pikës 6. Duke marrë në konsideratë faktin që tagrin, të parashikuar në Kodin Zgjedhor për të përcaktuar rastin e përdorimit të pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimit elektronik e ka Komisioni Rregullator, atëherë riformulimi i kësaj pike ka të bëjë me faktin që duke qenë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve do të jetë në kontakt të drejtpërdrejtë dhe është personi i ngarkuar, qoftë nga Kodi Zgjedhor, qoftë personi i autorizuar nga Komisioni Rregullator, për të ndjekur gjithë veprimet operationale, në rast

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.15.02.2022*

se votimi elektronik, për arsye të ndryshme teknike, nuk do të mund të vijojë, atëherë automatikisht për t'i dhënë këtë fleksibilitet, autorizohet apo ngarkohet nga Komisioni Rregullator, të vendosë vijimin e procedurës normale me fletë votimi siç ka qenë më parë. Pra, gjithmonë në rast përjashtimi nga rregulli. Formulimi që unë do të propozoj është ky. Atëherë, “në rastet kur votimi elektronik për arsye teknike që lidhen me pajisjen e votimit nuk mund të fillojë, pasi ka filluar dhe është ndërprerë, apo pasi ka filluar, është ndërprerë dhe nuk mund të vijojë, ngarkohet Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve të vendosë mbi vijimin e procedurës së votimit me fletë votimi”. I heqim dhe fjalët e fundit “sipas vlerësimit të situatës” sepse e kemi më parë. Pra, ta ripërsëris edhe njëherë? Atëherë të riformulohet pika 6 sipas këtij propozimi: “Në rastet kur votimi elektronik për arsye teknike që lidhen me pajisjen e votimit, nuk mund të fillojë, apo pasi ka filluar është ndërprerë dhe nuk mund të vijojë, ngarkohet Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve të vendosë mbi vijimin e procedurës së votimit me fletë votimi.”

Znj. I. Nano: Në fakt me sa po shikoj ndërhyrja juaj dhe propozimi konsiston në dy momente dhe pjesa “nëse ka filluar dhe është ndërprerë”. Mendoj që në respekt të kësaj çka propozuat është e drejtë për ta riformuluar për shkak se ndërprerja mund të jetë një moment, nuk mund të zëvendësohet. Pra, mendoj që ky saktësim është i domosdoshëm dhe pastaj dhe pjesa e autorizimit që Komisioni Rregullator i jep Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Nëse kolegët nuk kanë diskutim lidhur me këtë çështje, kalojmë në votimin e propozimit të zotit Çakaj, lidhur me riformulimin e pikës 6? Atëherë, votojmë propozimin e zotit Çakaj, për riformulimin e pikës 6, sipas propozimit të bërë publikisht në mbledhje.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Kundra: *S'ka*

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në pikën 7 të projektvendimit. Sikundër u tha nga Sekretari i Përgjithshëm, është situata që ndodh jo vetëm në kushtet e votimit elektronik, por dhe të votimit të zakonshëm. Është ndihma që i jepet një zgjedhësi që për arsye fizike nuk është në gjendje që të kryejë vetë procedurat e votimit. Pra, është një ndër parimet e përgjithshme të Kodit, i implementuar edhe në këtë projektvendim. Ndonjë çështje për diskutim, pyetje, propozime për shtesa apo ndryshime? Nëse jo, kalojmë në votimin e pikës 7 të projektvendimit.

Kush është dakord?

Pro: *5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)*

Kundra: *S'ka*

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në pikën 8, të projektvendimit që lidhet me përfundimin e procesit të votimit, mbylljen e pajisjes, skanimin e rezultatit për QV-në dhe transmetimin elektronikisht në aplikacionin e ngritur nga KQZ-ja. Kolegë nëse ka pyetje, diskutime, propozime?

Nëse jo, kalojmë në votimin e pikës 8.

Kush është dakord?

Pro: *5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)*

Kundra: *S'ka*

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 9. Rezultati paraprak nxirret dhe publikohet pasi është dërguar në KQZ, rezultati i votimit për çdo qendër votimi të Bashkisë Vorë. Zonja Vukaj, po!

Znj. H. Vukaj: Në këtë pikë kam paqartësinë se kur do të jetë ky orar. Pra, duke sjellë në vëmendje aktin, të cilin miratuam për procesin pilot në vitin 2021, i cili kishte një orar të standardizuar dhe dakordësuar prej interesave të palëve

politike në këtë proces. Duke qenë që dhe standardizimi i procesit elektoral përgjithësisht nuk ka arritur në ditët e tij më të shkëlqyera, do doja të dija se kur mendon administrata që do jetë ky orar, sepse e shoh pa një përcaktim konkret, ashtu siç ka qenë në pikën e aktit që ne miratuam vjet.

Z. Y. Merkaj: Rezultati paraprak nënkuptohet që të nxirret direkt pasi të dërgohen të dhënat nga qendrat e votimit, të cilat nuk janë zyrtare, nuk janë konfirmuar. Por, thjesht është dërguar nga operatori, ose nga një anëtar i komisionit të qendrës së votimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dhe merret rezultati paraprak dhe hidhet, publikohet. Por nuk është zyrtar, është thjesht rezultat paraprak. Dhe mendohet menjëherë sapo të mbyllet qendra e votimit, sapo merret rezultati dhe nxjerr pajisja atë kuponin e mbylljes së votimit.

Znj. H. Vukaj: A mendoni se jep siguri kjo mbajtja *tiro* e rezultatit të paeksponuar, qoftë edhe kështu siç e keni menduar?

Z. Y. Merkaj: Jo, nuk është se do ketë siguri dhe nuk japim siguri këtu, thjesht është rezultati paraprak dhe thjesht për efekt se Kodi ka përcaktuar që duhet një rezultat paraprak për çdo qendër votimi, dhe në votimet normale.

Znj. I. Nano: Është e njëjta situatë?

Znj. H. Vukaj: Siguri në raport me publikun. Pra, publiku këtë rezultat paraprak do ta marrë si një rezultat të mirëqenë?

Z. Y. Merkaj: Jo, ky dhe mund të ndryshojë, ndaj quhet rezultat paraprak.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Znj. H. Vukaj: Por duhet një orar, duhet një përcaktim, sepse...

Z. Y. Merkaj: Nuk është parashikuar që çdo qendër votimi mund ta mbyllë në të njëtin orar. Një qendër votimi mund ta mbyllë pak më shpejt, një pak më vonë.

Znj. H. Vukaj: Përgjithësues. Minimalisht këtu duhet të ketë. Ndërkohë që unë kam një propozim tjetër. Dua t'i rri standardit, le ta quajmë standard, ose të praktikës që krijuam në zgjedhjet e prillit 2021, dhe dua të propozoj orën 08:00 të mëngjesit, me qëllim që të mos impaktohen asnjë nga ata që bëjnë pjesë në proceset apo në etapat procesuale të nxjerrjes së rezultateve dhe kryesisht numëruesit.

Z. Y. Merkaj: Më falni, një shpjegim më të mirë, më të detajuar mund ta japë edhe shefi i sektorit.

Znj. I. Nano: Ja një moment ju lutem, dhe pastaj zoti Këlliçi! Në fakt nxjerrja e rezultatit paraprak nga KQZ-ja bëhet edhe në rastin e numërimit joelektronik, që do të thotë ne kemi një sistem transmetimi, në një vendim që e miratuam vetëm mbledhjen e kaluar, lidhur me përdorimin e kamerave në vendet e numërimit të votave dhe transmetimin në kohë reale të tyre, që do të thotë, në KQZ ndiqet *live*, drejtpërdrejt procesi i numërimit dhe në momentin që del rezultati paraprak publikohet. Pra, le të themi ky është mendimi im. Rasti i publikimit të rezultateve paraprake është një parim që zbatohet si për numërimin elektronik, ashtu edhe për atë manual. Ky ishte një sqarim që doja ta bëja publikisht, gjithsesi zonja Vukaj ka propozimin e vet për nxjerrjen e rezultatit paraprak, në orën 08:00 të mëngjesit, zonja Vukaj, apo?

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.15.02.2022*


Znj. H. Vukaj: Jo, rezultati përfundimtar duhet të dalë në orën 08:00 mendoj, meqenëse krijuam praktikën e pilotimit vitin e kaluar dhe këtu shoh që kemi parashikuar një pikë dhe ia kemi kushtuar rezultatit paraprak, i cili nxirret dhe publikohet pasi është dërguar në KQZ rezultati i votimit për çdo qendër votimi të Bashkisë Vorë, dhe s'kemi një pikë konkrete që thotë, rezultati përfundimtar do shpallet, kur?

Znj. I. Nano: Po, zoti Këlliçi!

Z. E. Këlliçi: Ne do i qëndrojmë edhe eksperiencës së vjetshme. Rezultati përfundimtar do shfaqet në orën 08:00 AM, parapraku, të ditës së nesërme, parapraku do jetë diku nga ora 08:30-09:00 që e presim ne, PM. Kjo për disa arsye. Arsyeja kryesore është që ne po pilotojmë dhe duam të testojmë sa në gjendje jemi ne që në kohë reale, nëpërmjet këtyre pajisjeve të mundet të nxjerrim një rezultat paraprak. Dhe e dyta është sa në gjendje jemi ne që të sigurojmë një transmetim në kohë reale nga QV-të drejt KQZ-së. Pra, ky është qëllimi i këtij pilotimi. Ndërkohë do vazhdohet procedura njësoj. Makinat do mblidhen në ZAZ dhe që aty ne do importojmë *usb*-të dhe do shfaqim rezultatin përfundimtar, që përsëri do quhet paraprak, sepse dhe ai do certifikohet më vonë, në orën 08:00 AM, por ndërkohë presim që diku nga ora 09:00 PM, të datës 6 mars, ne të kemi një rezultat paraprak.

Znj. I. Nano: Kush e ka thënë këtë që në orën 08:00 do shpallet rezultati përfundimtar? Të paktën në projektvendimin që na keni dërguar, propozimi juaj është ky: "Pa ikur pajisja e PEVN-së, skanohet rezultati i qendrës, dërgohet në KQZ", këtë disponon KQZ-ja për rezultat paraprak. Rezultati më tej del në KZAZ pasi grumbullohen të gjitha pajisjet elektronike të votimit dhe numërimit elektronik. Dhe në pikën 12 thuhet: "Pas dorëzimit nga të gjitha KQV-të pranë

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



KZAZ-së të pajisjeve dhe materialeve përkatëse, KZAZ-ja në prani të vëzhguesve kryen procesin e numërimit të votave në sistemin elektronik të menaxhimit të votimit dhe rezultateve sipas procedurave teknike dhe operacionale përcaktuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve”. Që do të thotë, unë duke e lexuar këtë, them, mbaroi procesi i votimit, fillon procesi i dorëzimit të materialeve zgjedhore në KZAZ. Në momentin që gjithë materialet zgjedhore përfshirë dhe PEVN-të janë në KZAZ, KZAZ-ja në prani të vëzhguesve kryen procesit e numërimit të votave, që do të thotë, mund të jetë ora 9 e darkës, 10 e darkës, 11. Pra, këtu nuk vendoset, këtu thotë, pasi kanë mbërritur të gjitha qendrat e votimit, 44.

Z. M. Çakaj: Më fal, një pyetje kisha unë. Po në rast se një nga këto qendra votimi nuk do të mbërrijë në KZAZ-së sipas përcaktimeve të këtij akti. A do të mund të shpallet ky rezultati paraprak?

Z. E. Këlliçi: Rezultati që do shpallet në ZAZ do shpallet vetëm kur të mblidhen të gjitha qendrat.

Z. M. Çakaj: Pra, jo domosdoshmërisht duhet t'i rrimë strikt një orari të publikuar këtu.

Z. E. Këlliçi: S'është e thënë!

Z. M. Çakaj: Pra, rezultati është i lidhur ngushtësisht me dorëzimin e gjithë PEVN-ve në KZAZ dhe me administrimin e gjithë informacionit?

Z. E. Këlliçi: Sigurisht, po!

Znj. H. Vukaj: Në funksion të kësaj logjike që sapo ngriti zoti Çakaj, më rri njëkohësisht edhe propozimi i bërë, që rezultati paraprak madje të jetë në orën 08:00 të ditës së nesërme, 08:00 AM, meqenëse paskemi dhe eventualitetin apo riskun se ndonjë QV nuk do të sjellë rezultatin.

Znj. I. Nano: Atëherë unë doja vetëm, zonja Vukaj të saktësojë se pika 9 ku bëri propozimin, lidhet me rezultatin paraprak. Caktimi i orës 08:00 të ditës së nesërme lidhet me rezultatin paraprak në propozimin tuaj apo me pikën 12? Që të dimë cilin propozim do të votojmë.

Znj. H. Vukaj: Po e saktësoj dhe lidhet me pikën 9, tashmë dhe me logjikën e dytë të ndjekur nga unë. Pas argumenteve që dëgjova nga administrata, do të preferoja që rezultati paraprak të jetë të nesërmen në 8 AM.

Z. Y. Merkaç: Ideja jonë ka qenë kjo, që kemi sjellë rezultatin paraprak, që qendrat e votimit t'i nisin elektronikisht në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Kjo ka qenë ideja jonë që e kemi shënuar.


Znj. I. Nano: Ashtu sikundër gjatë natës së datës 7 do të vijnë rezultatet paraprake nga qendrat e votimit, nga KZAZ-të e tjera, nga bashkitë e tjera. Atëherë jemi tek pika 9 dhe kemi propozimin e zonjës Vukaj. Rezultati paraprak nxirret dhe publikohet në orën 08:00 të mëngjesit, të datës 7 mars, të ditës së nesërme, pasi është dërguar në KQZ rezultati i votimit për çdo qendër të votimit të Bashkisë Vorë. Jam korrekt me propozimin? Pra, në orën 08:00 të ditës së nesërme. Kolegë keni vetëm një propozim për pikën 9.

Kush është dakord me propozimin e zonjës Vukaj?

Pro: 1 (znj.Vukaj)

Kundra: 4 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, , z.Çakaj)

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Rrëzohet propozimi i zonjës Vukaj. Duhet t'i rikthehemi votimit të pikës 9, sipas draftit të paraqitur nga Komisioneri.

Kush është dakord me pikën 9, sipas propozimit të ardhur?

Pro: 4 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, , z.Çakaj)

Kundra: 1 (znj.Vukaj)

Me 4 vota pro, 1 kundër, miratohet pika 9 sipas propozimit të Komisionerit! Kalojmë në pikën 10. Nuk po i lexoj të gjitha pikat. Thamë nëse ka një ndërhyrje, pyetje, sqarime, propozime për shtesa, ndryshime? Nuk ka! Kalojmë në votimin e pikës 10,

Kush është dakord kolegë, me pikën 10?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 11. Dorëzimi pranë VNV-së i pajisjeve nga ana e çdo KQV-je, bashkë me materialet e tjera zgjedhore. Nuk ka diskutime! Kalojmë në votimin e pikës 11.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 12. E trajtuam edhe më herët në përmbajtje. Po, zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Kemi një shtesë në funksion të ndërhyrjes që bëmë tek pika 3. Thjesht, me akt të Komisionerit, në fund kemi po të njëjtin perifrazim: "sipas procedurave të përcaktuara me akt të Komisionerit"

Znj. I. Nano: Besoj ky është saktësim?

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Znj. H. Vukaj: Po!

Znj. I. Nano: Nuk kemi nevojë për votim. Atëherë votojmë pikën 12, me saktësimin që sapo bëri zonja Vukaj.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 13. Llogaritja e rezultatit nga asistimi, shfaqja në monitor, printimi dhe tabela e rezultateve. Kolegë?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 14. Firmosja e tabelave si për qendrat e votimit dhe për bashki.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet pika 14 sipas propozimit të ardhur!

Pika 15. Është pikërisht një proces që potencialisht mund të ndodhë. Pra, rasti kur ne theksuam dhe më herët, kur kemi në një pjesë të ditës procedurën të zhvilluar elektronikisht dhe në një pjesë të ditës manualisht atëherë aktivizohen GNV-të sikundër dhe në bashkitë e tjera për të kryer procesin e numërimit elektronik.

Kolegë, kush është dakord me pikën 15?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 16. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve kujdeset për informimin e zgjedhësve dhe të administratës zgjedhore në lidhje me përdorimin e PEVN-së. Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Ndjesë edhe njëherë! Një saktësim tek pika 15. Po i rikthehem edhe njëherë, pavarësisht vullnetit të shprehur, por për publikun apo për ata që do të procesojnë dhe janë të interesuar për të lidhur procedurën, meqenëse parashikojmë një rast eventual kur një pjesë e votimit do jetë elektronikisht dhe pjesa tjetër do jetë manualisht, si parashikohet? Si e keni parashikuar, le të themi asimilimin e të dyja rezultateve, kur do dalë elektroniku?

Znj. I. Nano: Po, zoti Këlliçi!

Z. E. Këlliçi: Në këtë rast do bëhet kombinimi i qendrës së votimit ose i qendrave të votimit që kanë pasur probleme duke shtuar votat elektronike, plus votat e numëruara nga grupet e numërimit, të ngritura në ZAZ. 26

Znj. I. Nano: Pra rezultati, qoftë edhe parapraku, do dalë pasi të numërohen edhe votat fizike.

Z. E. Këlliçi: Patjetër!

Znj. H. Vukaj: Po afati i rezultatit elektronik do ndjekë fatin e rezultatit fizik?

Z. E. Këlliçi: Patjetër!

Znj. I. Nano: Atëherë jemi tek votimi i pikës 16.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 17. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 18. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pasi kemi votuar në parim dhe nen për nen projektvendimin, edhe njëherë kolegë, lidhur me votimin në tërësi?

Kush është dakord në tërësi me projektaktin?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Sikundër thamë në fillim, çështje tjetër në rendin e ditës nuk kemi, jashtë rendit të ditës nuk u propozua asnjë çështje tjetër, kështu që me miratimin e vendimit e deklaroj mbledhjen të mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr. 18

Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA

